



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	22.01.2024 <u>01-463/01-883</u>
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - me numër të parcelës 396/1 - Objekti i Qumështores

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17 pika 6 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të formimit të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 22.01.2024 e parashtrohet në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës të formojë komisionin vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, me numër të parcelës 396/1 - Objekti i Qumështores.
2. Kryetari i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar.
3. Ky komision vlerësues ka mandat për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale sipas pikës 1 të këtij propozim vendimi.

Me respekt!